



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:085170
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05647001

C.nr.120/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh. K. nga të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Spahiu, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit 678.00 euro, jashtë seancës, më datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses Xh. K. nga, dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditorë, për periudhën nga data 24.06.2022 deri më datë 05.03.2024, për 339 ditë pune, t'ia paguaj shumën e të hollave prej **678.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë 13.03.2024, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 13.03.2024, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit prej 678.00 euro. Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune të paditura në SHFMU "Sadri Misini", në fshatin Shipashnicë të Epërme, Komuna e Kamenicës, në pozitën e arsimtares lëndore. Baza ligjore për kompensimin e shujtës ditore në lartësi 2 euro, për 339 ditë pune, ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive në Nivel të Ndërmarrjes, të dt.31.01.2020, në nenin 16 parag.1, e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës të Kosovës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, si dhe shumën prej 20 euro për taksën gjyqësore.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka theksuar se është i pakontestueshëm fakti se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, po ashtu ka theksuar se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë matëriale se Komuna e Kamenicës, ne draft buxhetin për vitin 2023, është paraparë ndarje e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve ne pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore. Në bazë të nenit 16 parag.1, e paditura për shkak të ungesës së buxheit dhe pa mundësisë financiare nuk ka bërë ndonjë ndarje specifike për kompensimin e shujtës ditore press ë paku 2 (dy) euro, për një ditë pune, me tutje ka shtuar se e kundërston kërkesëpadinë e paditësit edhe nga fakti se palët nënshkruese të kësaj kontrate kanë shprehur në mënyrë deklarative mundësinë e vullnetit të përmbushjes së nenit 16, nga të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartasi se padia e paditësit është tërësisht e bazuar.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ *kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU ”Sadri Misini”, në fshatin Shipashnicë të Epërme, Komuna e Kamenicës, në pozitën e arsimtares lëndore.

Andaj, gjykata sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së tij, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive në nivel të Ndërmarrjes, të datës 31.01.2020, konkretisht nenin 16 paragrafi 1 të kësaj Kontrate, ku citohet se 1.“*Sipas mundësisë financiare të Punëdhënësit, të punësuarit do të kompensohen ne emër të shujtës ditore në shumë prej së pagu 2 (dy) euro për një ditë pune; 2. Kompensimi ne emër të shujtës ditore do të bëhet nga Punëdhënësi në bazë mujore, në periudhë korelative me kompensimin e pagës mujore*” ndërsa ne nenin 4 parag.3 citohet “*Te gjitha të drejtat dhe detyrimet që janë të përcaktuara me Ligjin e Punës, Kontratën e Përgjithshme Kolektive dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e që*

shprehimisht nuk janë të specifikuara me dispozita të veqanta të KKN-së, janë të zbatueshme plotësisht dhe si të tilla vërtetohen si obligim i palëve kontraktuese ne këtë KKN ”. Andaj, gjykata e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj për 339 ditë pune, shumën prej 678.00 euro, në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, nga data 24.06.2022 e deri më datë 05.03.2024.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësi është i punësuar pranë të paditurës, as fakti se i njëjti, ka gjithësej 339 ditë pune, (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi nr.287, i dt.06.03.2024, i lëshuar nga SHFMU “Sadri Misini”, në fshatin Shipashnicë, Komuna e Kamenicës, në emër të paditëses), por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e shujtës ditore.

Në bazë të nenit 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës, gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t’i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur në përgjigje në padi, se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë materiale se Komuna e Kamenicës, në draft buxhetin për vitin 2023, të ketë paraparë ndarjen e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve ne pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 1, të Kontratës Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, citohet se *“KKN lidhet nga palët në këtë kontratë për avancimin e rregullimit të marrëdhënieve juridike nga marrëdhënia e punës dhe respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të palëve nënshkruese”*, prandaj, Komuna e Kamenicës, është e obliguar ta zbatojnë KKN dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, po ashtu duke u bazuar në nenin 2, të kësaj kontrate, ku citohet se *“Kjo kontratë zbatohet ne marrëdhënie të punes vetem për të punësuarit ne sektorin e arsimit të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut, brenda territorit të Komunës së Kamenicës, si njësi unike e punës”*, paditësi, në rastin konkret, hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë, meqë i njëjti është i punësuar të e paditura. Andaj, përgjegjësia për kompensimin shujtës ditore është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8 % ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Numri i lëndës: 2024:085170
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05647001

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 20.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN –DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.120/2024, më datë 02.05.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi d.v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.